



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:163107

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05622173

AC.nr. 5186/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj - kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, në çështjen jokontestimore të propozuesve Zh. J. nga fshati D. dhe V. T. nga Lipjani, te cilët me autorizim i përfaqëson Sh. S. av. nga Lipjani, kundër kunderpropozuesit Republika e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli ne Prishtine, te cilin e përfaqëson Arsim Zuka, avokat nga avokatura shtetërore e Ministrisë se Drejtësisë së Republikës se Kosovës, për shkak të caktimit të lartësisë së kompensimit për paluajtshmerinë e shpronësuar dhe kompensimin e dëmit për paluajtshmerinë e mbetur jashtë shpronësimit, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësueses së autorizuar të kundërpropozueses e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, CN.nr.145/2015, i datës 22.03.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kundërpropozueses Republika e Kosovës - Qeveria e Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, CN.nr.145/2015, i datës 22.03.2021, sa i përket caktimit të lartësisë së kompensimit për paluajtshmerinë e shpronësuar dhe kompensimin e dëmit për paluajtshmerinë e mbetur jashtë shpronësimit, VËRTETOHET.

APROVOHET e themeltë ankesa e propozuesve Zh. J. nga fshati D. dhe V. T. nga Lipjani, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, CN.nr.145/2015, i datës 22.03.2021 sa i përket rrjedhjes së afatit të kamatës, ashtu që gjykohet si në vijim: kamata e gjykuar do të rrjedhë nga data 20.05.2015 deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, CN.nr.145/2015, i datës 22.03.2021, ka vendosur që të: APROVOHET propozimi i propozuesve Zh. J. nga fshati D. dhe V. T. nga Lipjani, NDRYSHOHET vendimi përfundimtar i Qeverise se Republikës se Kosovës nr.03/30 i dt.20.05.2015 dhe akt vlerësimi për pronat qe shpronësohen te dt.05.05.2015 sa i përket pjesës se shpronësuar te sipërfaqes prej 6978m² te ngastrës kadastrale nr.284-0, ne ZK Lipjan, OBLIGOHET Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore me seli ne Prishtine, qe propozuesve te ua paguaj kompensimin shtese për sipërfaqen e shpronësuar prej 6978m² te ngastrës nr.284-0 ne shumen prej 31.400,00.-€, si dhe ne emër te demit-uljes se çmimit për sipërfaqet e pa shpronësuar te te njëjtës ngastër kadastrale ne sipërfaqe prej 12436m² shumen prej 17.400,00.-€, qe te gjitha këto shuma me kamate prej 7% te interesit vjetor nga data 22.03.2021 e deri tek pagesa definitive, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës jokontestimore ne shume prej 1.847.60.-€. te gjitha këto shuma ne afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit te këtij aktvendimi nen kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm.

Kundër këtij aktvendimi përfaqësuesi i propozuesve, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e propozueses dhe ta ndryshoj aktvendimin e ankimuar sa i përket kohës së llogaritjes së kamatës duke e aprovuar në tërësi si në kërkesën e precizuar.

Kundër këtij aktvendimi përfaqësuesja e autorizuar e kundërpropozueses, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e kundërpropozueses dhe ta prishë aktvendimin e ankimuar si të kundërligjshëm, duke e lënë në fuqi raportin e vlerësimit të organit shpronësues.

Përgjigje në ankesë e kundërpropozueses kanë parashtruar propozuesit, duke e kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar ankesën e kundërpropozuesit dhe ka propozuar që të vërtetohet aktvendimi i ankimuar në pjesën e atakuar me ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJ) dhe gjeti se:

Ankesa e kundërpropozueses është e pathemeltë.

Ankesa e propozuesve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesit Zh. J. nga fshati D. dhe V. T. nga Lipjani, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 06.07.2015, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur propozim, për kompensimin e paluajtshmërisë së shpronësuar si dhe kompensimin e humbjes së vlerës së pjesës së pa shpronësuar, kundër kundërpropozueses Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore me seli ne Prishtine, kërkesë kjo e precizuar si në parashtresën e datës 27.03.2019, me të cilën ka kërkuar konkretisht si në precizimin e dorëzuar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit të propozuesve, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, CN.nr.145/2015 i datës 22.03.2021, me të cilin ka vendosur që të: Aprovohet propozimi i propozuesve në tërësi si i bazuar, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Me vendimin përfundimtar te Qeveris se Republikës se Kosovës nr. 03/30 te dt. 20.05.2015, është aprovuar shpronësimi për interes publik, përveç pronave tjera edhe për paluajshmerit ne ZK Lipjan, për ndërtimin e autostradës R... Prishtine-H. E., sektorit C1, e ku është përfshirë edhe një pjese e ngastrës nr.....-0, ZK Lipjan, ne pronësi te paraardhësit te propozuesve.

Më tej ka theksuar se: Me aktvlersimin për pronat qe shpronësohen te Departamentit te Tatimit ne Prone te Ministrisë se Financave te Qeveris se Republikës se Kosovës te dt. 05.05.2015, pjesa e ngastrës te shpronësuar nr.284-0 ne sipërfaqe prej 6978m2 ne ZK Lipjan, është vlerësuar 9,50.-€ për një metër katror, përkatësisht sipërfaqja e shpronësuar është vlerësuar ne lartësi te tërësishme prej 66.291.00.-€,

Më tej ka theksuar se: Ne raportin e vlerësimit për pronën e shpronësuar, te hartuar nga ekspertja gjyqësore F. S.-K.-vlerësues i pronave te paluajtshme, te dt. 26.12.2018 dhe sqarimet e dhëna ne seancën gjyqësore te dt.18.03.2019, prona e shpronësuar-ng.kad.nr.....-0 ZK Lipjan, është vlerësuar ne lartësi prej 14.00.-€ për 1m2, përkatësisht pjesa e shpronësuar e ngastrës kadastrale nr.....-0 ne sipërfaqe prejm2, është vlerësuar ne shume prej 97.692.00.-€ , ndërsa organi shpronësues këtë sipërfaqe te kësaj ngastre te shpronësuar, e ka vlerësuar ne lartësi prej 9.50,00.-€ për 1 m2, përkatësisht pronën e shpronësuar e ka vlerësuar ne shume prej 66.291,00.€ dhe ndryshimi nga vlerësimi i organit shpronësuar për këtë sipërfaqe te ngastrës kadastrale te shpronësuar dhe vlerësimi i ekspertit gjyqësor-vlerësues e pronave te paluajshme është ne lartësi prej 31.400,00.-€, ndërsa pjesa e pronës se pa shpronësuar i te njëjtës ngastër kadastrale ne sipërfaqe prejm2, ka vlerësuar se ka ulje te çmimit ne lartësi prej 10%, për shkak te pjesës tjetër te shpronësuar, e shprehur ne te holla propozuesit i është shkaktuar dem ne lartësi prej 17.400,00.-€, raport këtë te ekspertit, te cilin gjykata e vlerëson te hartuar ne baze te rregullave te profesionit, e i bazuar ne kontratat e shitblerjes te paluajshmeris te motorizuara tek noteri F. T. ne Lipjan me shenjen LRP.nr.3959/2016 te dt. 19.07.2016, me shenjen LRP.nr. 5524/2017 te dt. 18.09.2017, dhe kontratën e noterizuar tek noteri S. K. ne Lipjan me shenjen LRP1039/2015 te dt. 30.04.2015, dhe ne tersi ia fali besimin.

Më tej ka theksuar se: Me aktvendimin e për trashëgimi të lëshuar nga noteri E. N. nga G. me shenjen OPR red.br...../2020, dhe Ref.br..../2020 të dt. 30.10.2020, për trashëgimtare të pasurisë trashëgimore të të ndjerit J. J. ish nga fshati D., përveç për parcelat tjera edhe për pjesën ideale prej ½ se parcelës nr. 284-0 ZK Lipjan, është shpallur T. V. nga Lipjani, e tani propozuesja.

Më tej ka theksuar se: Nga ekspertiza gjeodezike e hartuar nga ekspertja gjyqësore e gjeodezisë D. T.-G., e dorëzuar në gjykatë me dt. 14.12.2018, Rezulton se pjesa e pa shpronësuar e ngastrës kadastrale nr. 284-0ZK Lipjan, në sipërfaqe prej 12436m², është mbetur në formë të çrregullt përkatësisht kësaj pjese të mbetur i ka humbur formë të cilën para shpronësimit e ka pasur.

Më tej ka theksuar se: Nga certifikata për njësi kadastrale P-.....4-002....-0 ZK Lipjan, e lëshuar nga ZKK me dt. 12.12.2018, rezulton se kjo ngastër kadastrale përkatësisht njësi kadastrale, në ZK në Lipjan në regjistrat ku mbahet evidenca e paluajshmerive në pronësi udhëhiqet në pjesë ideale me nga ½, në emër të J. J. (B.) dhe J. Zh. (B.).

Më tej ka theksuar se: Me dispozitën e nenit 15.1 të Ligjit nr. 03/L-2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, parashihet se kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni. Me dispozitën e nenit 18.3 të të njëjtit ligj parashihet se nëse në vendimin përfundimtar autorizohet shpronësimi i një pjese të një parcele të pronës së paluajtshme dhe si rezultat i këtij shpronësimi, pjesa e mbetur pëson humbje të vlerës, pronari i pjesës së mbetur ka të drejtë të paraqes ankesë në përputhje me nenin 37 të këtij ligji dhe të kërkojë nga gjykata kompetente nxjerrjen e një aktgjykimi me të cilën urdhërohet organi shpronësues që të paguaj kompensimin për humbjen e vlerës, nëse edhe vetëm për atë që nuk është parapare-në vendimin përfundimtarë. Konform këtyre dispozitave, e bazuar në mendimin e dhënë nga eksperti gjyqësor - vlerësues i pronave të paluajtshme, në raportin e vlerësimit të dt. 26.12.2018 dhe sqarimet e dhëna në seancën gjyqësore, gjykata erdhi deri të përfundimi të propozimit të propozuesit është i bazuar, që për pjesën e parcelës së shpronësuar të i kompensohet edhe shtesa prej 31.400,00-€, përkatësisht ndryshimi për metër katror prej nga 9.50.€ për një metër katror, i vlerësuar nga kundërpropozuesi me aktivlësimin e dt. 05.05.2015, në 14.00.-€ për metër katror të vlerësuar nga ekspertja gjyqësore –vlerësuese e pronave të paluajtshme, në tërë sipërfaqen e shpronësuar, duke vlerësuar se ky është çmimi real i tregut të paluajtshmërisë së shpronësuar, ndërsa për ulje të vlerës për pjesën e kësaj paluajshmerije të pa shpronësuar në sipërfaqe prej 12436m² të të njëjtës ngastër kadastrale në lartësi prej 10%, të i aprovohet shuma prej 17.400,00.-€, këtë për faktin se paluajtshmeria e pa shpronësuar para shpronësimit ka pasur formë drejtkëndore, ndërsa pas shpronësimit ka formë trekëndore, dhe në këtë formë me më shumë vështirësi mund të punohet, për çka gjykata konsideron se pjesa e pa shpronësuar ka ulje të vlerës për 10%.

Vendimi për kamatën ligjore është marrë në kuptim të nenit 16 par. 1 të Ligjit për shpronësim.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës jokontestimore është marrë në kuptim të 222 të LPJ-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është pjesërisht i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar pjesërisht në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës jokontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të kundërpropozueses se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës jokontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për aprovimin e propozimit e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që e njëjta drejt ka konstatuar faktin se pala kundërpropozuese, me vendimin përfundimtar nr.03/30 të datës 20.05.2015, e ka shpronësuar paluajtshmerinë e propozuesve për interes publik me qëllim të ndërtimit të Autostradës R.....Prishtinë-Ha..i E., dhe atë sipërfaqen prej m², nga ngastra kad. nr.....-0, ndërsa jashtë shpronësimit ka mbetur sipërfaqe prej ... m² nga ngastra kadastrale nr....., cila paluajtshmeri gjendet në Zonën Kadastrale Lipjan dhe pala kundërpropozuese sipas akt vlerësimit, për m² të paluajtshmerisë së propozuesve e ka vlerësuar në lartësi prej 9.50€, për m², e në shumë të përgjithshme prej 66,291.00 euro, vlerë kjo për të cilën propozuesit nuk janë pajtuar dhe nuk janë dakorduar me arsyetimin se pjesa që është shpronësuar ka vlerë më të lartë të tregut dhe që pjesa e mbetur jashtë shpronësimit nuk e ka vlerën e saj të mëparshme dhe ka pësuar humbje si rezultat i shpronësimit të kësaj pjese, fakt ky i vërtetuar nga provat që gjinden në shkresat e lëndës.

Gjithashtu Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se-0, ka vlerë të tregut prej 14.00€/m², apo dallimi i vlerësimit të çmimit të tregut nga vlerësimi i bere nga organi shpronësues është prej 4.50.-€, për 1/m², ashtu që duke e llogaritur sipërfaqen e shpronësuar prej m², e ka gjykuar shpërblimin shtesë prej 31,400.00-€, ndërsa për pjesën e paluajtshmerisë së mbetur jashtë shpronësimit prej m², e cila ka pësuar humbje në shkallë prej 10%, e ka gjykuar shumën prej 17,400.00-€, fakte këto të vërtetuara nga ekspertiza e ekspertit F. S.-K.-vlerësues i pronave te paluajtshme, te dt. 26.12.2018 dhe sqarimet e dhëna ne seancën gjyqësore te dt.18.03.2019, e dhënë për parcelën kontestuese, të cilës ekspertizë edhe gjykata e Apelit ja fali besimin e plotë pasi që e njëjta është përpiluar në baza ligjore dhe shkencore, pasi që eksperti gjatë vlerësimit dhe përcaktimit të vlerës reale të çmimit të tregut për pjesën e shpronësuar si dhe pjesën e mbetur pa shpronësuar është bazuar në metodën krahasimore

e cila ka bërë krahasimin e tri kontratave të shitblerjes së paluajtshmërive, të cilat kanë qenë të legalizuara dhe në bazë të këtyre ka nxjerrë edhe çmimin real të kësaj paluajtshmërie e gjithashtu ka përcaktuar edhe vlerën e humbur të pjesës së parcelës së mbetur jashtë shpronësimit e cila ka përcaktuar se ka vlerë të [humbur në shkallën 10% për shkak të humbjes së formës e cila është specifikuar edhe në ekspertizën e dhënë me shkrim.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se: Me nenin 15 paragraf 1 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (ligji nr. 03/L-139), përcaktohet se: “ Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6, të këtij neni “, ndërsa me paragrafin 6 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të miratojë akte nënligjore për përcaktimin e metodologjisë për llogaritjen e kompensimit për pronën e shpronësuar dhe dëmet që kanë në bëjnë me shpronësimin. Këto akte nënligjore duhet të jenë në përputhje me: 6.1. këtë nen 15, 6.2. vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe 6.3. parimet ose udhëzimet tjera për llogaritjen e kompensimit të cilat janë nxjerrë ose sugjeruar nga organizatat ndërkombëtare financiare.

Me nenin 36 paragraf 1 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, përcaktohet se: “ Nëse në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, një Organ Shpronësues nxjerr një Vendim Përfundimtar, çdo Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën dhe/ose të drejtat të cilat janë objekt i këtij vendimi mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve të cilat janë përcaktuar në vendim se do t’i paguhen atij Pronari dhe/ose Zotëruesi të Interesit”, ndërsa me paragrafin 6, të po këtij neni, përcaktohet se: “ Nëse ankesa dorëzohet në përputhje me këtë nen në përputhje me këtë ligj, gjykata është e autorizuar të bëjë ri-llogaritjen e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve të përcaktuara në vendimin e organit shpronësues. Nëse gjykata konstaton se shuma e kompensimit dhe/ose dëmeve e përcaktuar në vendimin e organit shpronësues është më e ulët ose më e lartë se shuma e cila kërkohet sipas këtij ligji, gjykata nxjerr aktgjykim me të cilin e ndryshon Vendimin Përfundimtar të Organit Shpronësues dhe e rregullon shumën e kompensimit për shpronësim dhe/ose dëmeve “.

Me nenin 37 paragraf 1 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, përcaktohet se: “Nëse me Vendimin Përfundimtar autorizohet shpronësimi i një pjese të një parcele të pronës së paluajtshme dhe, si rezultat i këtij shpronësimi, pjesa e mbetur pëson humbje të vlerës (ose me arsye pritet se do të pësojë humbje të vlerës), Pronari i pjesës së mbetur ka të drejtë të paraqesë ankesë në përputhje me nenin 37 të këtij ligji dhe të kërkojë nga gjykata kompetente nxjerrjen e një aktgjykimi me të cilin urdhërohet Organi Shpronësues që të paguajë kompensimin për humbjen e vlerës, nëse – dhe vetëm për aq sa nuk është paraparë – në Vendimin Përfundimtar”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë në këtë drejtim drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe se kundërpropozuesja ka për detyrim që propozuesve për pjesën e paluajtshmërive të shpronësuar dhe për pjesën e mbetur jashtë shpronësimit t’ia bëjë kompensimin në emër të vlerës së humbur, në shumën e gjykuar si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale kur ka vendosur në lidhje me llogaritjen e afatit të rrjedhjes së kamatës, kur ka vendosur që të afati i llogaritjes së kamatës fillon nga dita 22.03.2021 kur është marrë aktvendimi i ankimuar, pasi që me nenin 16 paragraf 2, pika 2.2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, përcaktohet se: “ Organi Shpronësues ia paguan, ose kërkon nga parashtruesi i kërkesës ose Përfituesi i pritur - nëse ka të këtillë - që t’ua paguajë shumën e kompensimin të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar, Pronarit të prekur ose Zotëruesit të Interesit. Kompensimi i kërkuar në Vendimin Përfundimtar do të jetë: “ interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë përqind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore “. Andaj, në rastin konkret gjykata e Apelit vlerëson se afati i interesit (kamatës) duhet të llogaritet nga data e publikimit të vendimit përfundimtar në Gazet Zyrtare me datë 20.05.2015 dhe jo siç është llogaritur nga gjykata e shkallës së parë nga dita e nxjerrjes së aktvendimit të ankimuar me datë 22.03.2021, andaj dhe të njëjtin e ndryshojë dhe vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktvendimi që afati i kamatës të fillojë nga data 20.05.2015 e deri në pagesën definitive.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPJ-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) e LPK-së, e lidhur me nenin 3 të LPJ-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5186/2021, me datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v

Numri i lëndës: 2019:163107
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05622173